



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut
Opština Kaçanik
Municipal of Kaçanik

01Nr.60/01-13665/25
Kaçanik, 24.06.2025

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **VI (gjashtë)** e Rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (Legjislatura e VII e Kuvendit të Komunës), mbajtur me 24.06.2025, në ora 11:00. Mbledhja u mbajt në katin e dytë të objektit të administratës komunale, në sallën e komiteve të KK, me fillim pune në ora 11:00.

Nga përbërja e përgjithshme e Komiteti për Politikë dhe Financa- KPF prej 7 anëtarëve, pjesëmarrës në mbledhje ishin 7 anëtarët-të gjithë: Kemal Murseli, Kadri Krivenjeva, Rrustem Zenuni, Agim Mani, Kadrije Lika-Troni, Ardita Rrahmani, Edona Luzha.

Nga Ekzekutivi i Komunës, pjesëmarrës: Kryetari i Komunës-Besim Ilazi, Nënkryetari i komunës -Sabedin Vishi, Drejtorët e Drejtorive: Bahri Selimi-DBF, Suad Dullovi-DBPZHR, Ramadush Osmani-DSHPE, Pranvera Loku-Zharku-DZHE, ndërkaq nga zyrtarët në kuadër të detyrave të punës ishin: Valdrin Dogani- ZKF, Fatlume Guri-Selimi- Zyra e Informimit, Makfire Malsiu-Zyra e KK.

Nga OSBE, mbledhjen e monitoroj, Faruk Dërmaku.

Mbledhjen e kryesoj, Kemal Murseli, Kryesues i Kuvendit.

Procesmbajtës: Makfire Malsiu, Zyrtare e Lartë për Punë të KK.

Fillimisht Kryesuesi i Kuvendit, Kemal Murseli, i përshëndeti pjesëmarrësit e kësaj mbledhje, konstatoj kuorumin, pastaj e hapi mbledhjen e VI (gjashtë) të rregullt të KPF-së për vitin 2025, data 24.06.2025, me këtë:

REND PUNE

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;
2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2026-2028;
3. Propozim Rregullorë për transportin rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut;
4. Propozim Rregullorë për transparencë e komunës së Kaçanikut;
5. Plani i veprimit për transparencë e komunës së Kaçanikut;
6. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2025.

Lidhur me rendin e punës, e hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë rendin e punës e shtroj në votim për aprovim dhe i njëjti u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF,

Aprovoj

Rendin e punës në përbërje prej 6 pikave.

U kalua në shqyrtimin e pikave sipas renditjes:

1. Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar e KPF;

Procesverbali i mbledhjes së kaluar të KPF u aprovua njëzëri pa vërejtje. Në saje të kësaj del konstatimi së KPF e,

Aprovoj

Procesverbalin e mbledhjes së V (pestë) të rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) për vitin 2025 të datës 26.05.2025/ Lënda: 01Nr. 60/01-10961/25.

2. Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2026-2028;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori i Financave, Bahri Selimi është këtu për sqarime të nevojshme, prezentë është edhe Valdrin Dogani-ZKF. E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Ky është dokument orientues deri me miratimin e buxhetit 2026, mund të bëjmë ndryshime. Kërkoj që në këtë dokument të përfshihen të gjitha grupet e interesit në debate deri në miratimin e buxhetit. Pyetje për drejtorin: Buxheti për vitin 2026, a do të jetë me i vogël, për shkak të rënies së numrit të popullsisë? E dyta, të IK, pse ka rënë planifikimi i investimeve në raport me vitet e kaluara?

z. Bahri Selimi: Ne e kemi pranuar Qarkoren e parë buxhetore, ku ministria i jep kufijtë fillestar të buxhetit. Në vitin 2026, buxheti është 13,169,753.00 €, krahasuar me vitin aktual, është buxheti me i madh për 577 mijë euro. Në realitet, nëse shikojmë rritjen e shpenzimeve, është më i vogël, sepse kemi ngritje të pagave nga ky vit dhe në vitin tjetër 1 milion 170 mijë euro. Shuma e ngritur prej gjysmë milioni që është rritur, janë borgj për me i mbuluar pagat e vitit të ardhëm. IK janë zvogëluar 648 mijë për me i mbuluar pagat, IK nga 3.4 milion në 2.8 milion. Qarkorja është bërë me numrin e ri të popullsisë për 27716 banorë, por nuk janë marrë parasysh mbulesa reale e shpenzimeve që është dashur me qenë një 12% vlera reale e barabartë, por rritja e përqindjes është 4.6. Grantet specifike janë rritur: Granti i përgjithshëm për 117,883.00€, i arsimit, 135,617.00€, granti i shëndetësisë 209,282.00€. Të asnjëra prej këtyre, granti specifik nuk është rritur në raport me rritjen e pagave. Ju e dini që ngritje të pagave ka me pasur edhe nga muaji korrik, kështu ne jemi munduar që këtë buxhet me shpërndarë me i mbuluar pagat, kategoria e MSH për shkak të mungesës së buxhetit, është zvogëluar, shërbimet komunale i kemi lënë të njëjta, subvencionet dhe transferet janë të njëjta. Të pagat, kostoja është shumë e ngritur, ministria është dashur me pasur parasysh dhe me ndarë buxhet me i mbuluar shumën e ngritur të pagave.

z. Agim Mani: A keni plan drejtor për ngritjen e të HVK, se të HVK vazhdimisht shkojnë njëjtë, kurse standardi po rritet, po rritet edhe granti qeveritar -GQ, ndërkaq të HVK rriten në përqindje shumë të vogël?

z. Bahri Selimi: Projektionet e të HVK janë pjesë e buxhetit, financimi qeveritar është 12 milion, të HVK janë 1 milion buxheti është 13,169,753.00 €. Në këtë shumë që na e ka dërguar ministria, janë të përfshira edhe të HVK të planifikuara me u inkasua. Kur të vendosin projektionin e të HVK merren për bazë sesa kemi fatura të tatimit në pronë-TP, dhe të hyra tjera. Të HVK gradualisht janë në rënie e sipër, pasi shumë inkasime janë në nivel qendror, se janë bërë disa ndryshime nga niveli qendror pa na pyetur neve, si çështje të kadastrit, do kushtëzime të tatimi në pronë, që janë hequr krejt. Neve do borgje janë duke na u rritur në TP, burimet e komunës janë të pakta, taksat e bizneseve na janë hequr etj. Ne nuk mundemi me i ngritur të HVK jashtë asaj që mundemi me i mbledhur. Ne vit pas viti kemi shënuar një ngritje të vogël të inkasimit. Të HVK, janë projektuar 1,065,071.00€ është real apo 8.9% e buxhetit.

z. Agim Mani: Dëgjimet publike që janë mbajtur deri me tani për KBAK, ka qenë mirë me i sjellë, që të dimë me qartë në detaje se çka është kërkuar në debate. Besoj se në KK do t'na ofroni.

Kryesuesi i Kuvendit: Procesverbalet publikohen të gjitha, publikohet edhe KBAK në faqe të komunës, mundeni me i gjetur.

z. Agim Mani: Nuk është e kushtueshme me na sjellë si dokument.

Kryesuesi i Kuvendit: Për me i ditur detajet, duhet me qenë në debat publik, e ju nuk keni qenë asnjë. Procesverbali publikohet, kështu mos të ngarkojmë një zyrtar veç se po kërkon dikush. Procesverbali publikohet për qytetarë e komunës dhe për çdo të interesuar tjetër. Në këtë drejtim jemi në rregull. Drejtor, unë nuk e pash të IK përfshirjen e rrugës "Ahmet Kaçiku". Nuk po flas për mjete, se mundet edhe mos me pasur, por prej agjendës nuk bënë me u hequr, se është një projekt që kanë investuar qytetarët, dhe kurdo që jepet mundësia, kjo rrugë duhet me pasur një kod buxhetor, që me u realizuar ashtu qysh është planifikuar nga vet qytetarët. Për KK mundësisht me përfshirë si kod buxhetor, pastaj të mjetet qysh është mundësia realizohet.

znj. Ardita Rrahmani: Në KBAK paraqitën QMF të cilat nuk janë funksionale. Ndoshta kishte me qenë mirë që DSHMS me u angazhuar në funksionalizimin e QMF, pasur parasysh që thuhet se nuk ka staf adekuat, gjë që e kuptoj, por të paktën duhet me insistuar në funksionalizimin e tyre, sepse është mbingarkesë edhe për QKMF në Kaçanik. Janë 6 QMF në krejt komunën e Kaçanikut që operojnë, është mirë me i funksionalizuar, se në dokument thuhet se nuk janë plotësisht funksionale.

Kryesuesi i Kuvendit: Në Doganaj është QMF që përfshinë një pjesë bukur të madhe të popullatës dhe QMF në Kaçanik të Vjetër.

znj. Ardita Rrahmani: Unë po flas në bazë të dokumentit, nëse gjendja në terren është ndryshe, duhet të përmirësohet në raport.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Janë QMF që nuk munden me u bërë funksionale, si Ivajë, Elezaj, Strazhë, ndërkaq funksionale janë në Doganaj, Kaçanik të Vjetër, Begracë, Stagovë, Gllloboçicë. Në Strazhë ka qenë pjesa vullnetare, tani nuk është. Në Bob nuk është funksionale, për shkak se në vijë ajrore është 500m QKMF.

znj. Ardita Rrahmani: Pse atëherë kjo është bërë si kritikë edhe në KBAK se është mbingarkesë për QKMF jo funksionalizimi i QMF-ve ?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Mirë është me pasur QMF funksionale edhe nëse vendbanimi ka vetëm një banorë, por a ke mundësi me i pasur funksionale. Tani është infrastruktura që shumë shpejtë arrijnë në QMF tjetër. Jemi duke bërë një ri dizajn tjetër, që me pasur qasje të gjithë qytetarët nga me shkuar. Përpos ambulancave që i kemi, disa i kanë bërë në formë vullnetare, tani janë shpopulluar fshatrat, që është problem me mbajtur ambulancën. Ambulancat janë të gjitha, por nuk kemi mundësi me i bërë funksionale edhe me stafin që e kemi këtu dhe nuk ia vlen, mundet me pasur 1 apo 2 herë në javë vizita mobile edhe kujdesin paliativ. Jemi duke shikuar formën qysh me iu dalë në ndihmë qytetarëve, por mos e merrni atë se duhet me funksionalizuar një QMF se është objekti. Ajo është mirë, por është problem me stafin që kemi, dhe për shkak të zvogëlimit të numrit të banorëve. Buxheti ka me ardhur duke u zvogëluar vit për vit, se buxheti ndahet për kokë banori. Fjala vjen, nëse e kemi vetëm një nxënës në një shkollë, ministrisë nuk i intereson, ai të ndanë buxhetin për atë nxënës 23 €. Çka mundesh me bërë me këtë shumë të mjeteve? Ne duhet me gjetur format e brendshme qysh me mbijetuar situatën, për derisa nuk merret ndonjë reformë nga niveli qendror në arsim dhe shëndetësi. Shqipëria e ka aplikuar këtë reformë para 6 viteve, e ka një numër të kufizuar dhe detyrohet me iu bërë transportin, që mos më iu lënë hapësirë qytetarëve për ankesa. Të ne kjo ende nuk është bërë, duhet me gjetur formën me iu shërbyer qytetarëve, ndërkaq me i mbajtur QMF e kemi shumë problem.

znj. Ardita Rrahmani: Unë kam qenë e zëshme në seanca të KK sa i përket rënies të numrit të popullsisë. E themi me modesti, ndoshta jam e vetmja që kam ngritur këtë çështje. Unë kam bërë thirrje me marrë ndonjë veprim të nevojshëm, për mos me ra numri i popullsisë e mos me na ikur investimet. Ikja e popullsisë në vende tjera, po vjen edhe si pasojë e mungesë së PZHK. Unë nuk di çka mundet me bërë me tepër sesa me fol një anëtar i KK, por pasojat e kësaj kemi me i bartur të gjitha subjektet politike.

z. Rustem Zenuni: Regjistrimi i popullsisë, unë mendoj se është bërë gabim, sepse janë përjashtuar qytetarët e Kosovës nga regjistrimi, janë diku 30% e diasporës nuk janë regjistruar.

znj. Ardita Rrahmani: A është bërë gabim apo jo, për 10 vjet kemi me pasur këtë regjistrim të popullsisë me 27716 banorë.

z. Rustem Zenuni: Mundet me ndryshuar, me pasur përsëri regjistrim të popullsisë.

Kryesuesi i Kuvendit: Çështja e regjistrimit të popullsisë, nuk është në kompetenca tona, pavarësisht qysh është bërë, ne si komunë e kemi numrin diku 27716 banorë.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Kanë qenë të përcaktuara kriteret për regjistrim të popullsisë.

znj. Ardita Rrahmani: Kriteret kanë qenë të përcaktuara, ndërkaq pse nuk janë regjistruar krejt ata të diasporës, ajo është çështje e tyre, nuk është në përgjegjësi tonë. Kryesues, po e përmendni se nuk keni marrë pjesë në debate publike me qytetarë. Ne jemi anëtarë të KK dhe fjala jonë dëgjohet në KK. Prej praktikave të hershme po e themi, kur kemi marrë pjesë në debate publike, nuk është se ka ndodhur ndonjë ndryshim në buxhet.

Kryesuesi i Kuvendit: Për me ditur krejt rrjedhjen e debatit publik, duhet me marrë pjesë vet në debat, se përndryshe mundeni me thënë se nuk janë shënuar krejt zhvillimi i debatit.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kryesues, ne të njëjtën kohë kemi të drejtë me kërkuar procesverbalin e debatit publik me qytetarë.

Kryesuesi i Kuvendit: Po, keni të drejtë me kërkuar si informatë, janë të publikuara proceset dhe i merrni nga faqja zyrtare e komunës.

znj. Kadrije Lika-Troni: Kryesues, ne kemi të drejtë me kërkuar nga zyrtari përkatës procesverbalin e debatit publik.

Kryesuesi i Kuvendit: Po keni të drejtë me kërkuar me iu ofruar dokumenti i cili nuk është i publikuar në faqe zyrtare, ndërkaq për ato që janë të publikuara, nuk keni të drejtë me kërkuar, sepse e merrni nga faqja zyrtare, duhet të dimë t'i dallojmë këto çështje.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të analizat laboratorike, thuhet se është shtuar numri i llojit të analizave. Nëse është shtuar numri i llojit të analizave, nuk është marrë asnjë veprim prej komunës, as prej drejtorit që e udhëheqë QKMF. Unë kam kërkuar vazhdimisht që me u ngritur kapacitetet dhe orari, e jo qysh është duke funksionuar deri me tani, se qytetarët janë të detyruar me dal privat me i bërë analizat, sepse analizat munden me i bërë deri në ora 13:00 nëse je rast urgjent, në të kundërtën duhet me caktuar termin për nesër. Fshatrat në largësi dhe ndonjë qytetarë që nuk mundet me ardhur nesër, i duhet me shkuar me i bërë analizat privat, se nuk janë duke funksionuar kapacitetet në QKMF. Edhe pse QKMF është duke funksionuar mirë me të gjitha kapacitetet, ndërkaq sa i përket analizave laboratorike, ka ankesa të vazhdueshme të qytetarëve. Unë e kam ngrit si shqetësim këtë çështje, por nuk po merret parasysh. Nuk e di arsyen pse, drejtori nuk është këtu prezentë në mbledhje për me na dhënë sqarime të nevojshme?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Në momentin që bëhet kërkesa për ngritjen e kapaciteteve shëndetësore, ata e analizojnë-QKMF, jo ne. Unë askund nuk kam pa që bëhen analizat pas orës 13:00.

znj. Kadrije Lika-Troni: Në Shtime, 12 orë bëhen analizat, ndërkaq 24 orë për diçka analiza tjera. Unë vet kam pasur rast, është dashur me prituri mëngjesin për me u diagnostikuar leukocitet. Nuk është në rregull që për një analiza të zorrës qorre me shkuar pacienti në Ferizaj apo në Prishtinë apo ndonjë analizë tjetër. Për atë po themi se kapacitet janë shumë të vogla në krahasim me popullsinë, analizat bëhen nga 8-13, pas kësaj ore nëse nuk kanë terminë kthehen prapa.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Askush nuk kthehet prapa për analiza veç se nuk ka terminë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Unë kam me ua sjellë informatën, se pa terminë, nuk bëhen analizat këtu në QKMF. Pranoje kryetar se, QKMF nuk ka kapacitete të mjaftueshme sa i përket analizave laboratorike.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Kapacitetet laboratorike në QKMF janë të mira për analiza. Janë dy laboratorë për 27 716 banorë. Orari i analizave gjithmonë ka qenë nga 8-13 ora. Njëjtë ka qenë kur komuna i ka pasur mbi 45 mijë banorë. Në bazë të numrit të banorëve, rritet edhe kapacitetet.

Kryesuesi i Kuvendit: Në momentin që për raste urgjent duhet analiza, nuk ke me pasur mundësi me trajtuar në Kaçanik, ke me shkuar në Ferizaj për analiza dhe procedura të mëtutjeshme.

znj. Kadrije Lika-Troni: Çështja është se, qytetarët kur kontrollohen të mjeku, e ka udhëzimin për analiza për laborator, kur të shkon për analiza, e pyesin a ke terminë, nëse nuk ka terminë, i thonë se sot nuk mundesh me i bërë analizat, e lënë për nesër.

Kryesuesi i Kuvendit: Analizat që nuk janë urgjente, trajtohen këtu, ato që janë urgjente bëhen në urgjencë. Shërbimet në QKMF mundemi me thënë se janë me të mirat në rajon. Nëse në ndonjë shërbim çalojmë, në QKMF nuk çalojmë.

znj. Kadrije Lika-Troni: Të shërbimet laboratorike me terminë, unë jam duke thënë, pse mos me pasur mundësi me u zgjatur orari, që mos me u kthyer qytetari prapa.

Kryesuesi i Kuvendit: Aq ndoshta janë kërkesat, se në momentin që paraqitet nevoja, besoj se e zgjasin orarin e analizave laboratorike.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Je duke thënë Kadrije, se askush nuk kthehet prapa, pa i bërë analizat, po flas për analizat që bëhen në QKMF.

znj. Kadrije Lika-Troni: Nëse qytetari apo unë shkoj tani për analiza të gjakut, kur të shkoj, me jep udhëzimin për laborator, ndërkaq laborator i me pyet a ke terminë, nëse jo, të thotë, vjen nesër.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Pse nuk po shkon atëherë me kohë, kur e ke udhëzimin?

Kryesuesi i Kuvendit: Kur janë analizat me urgjencë, është vendi ku bëhen analizat urgjente.

z. Agim Mani: Për derisa funksionon urgjenca, paralelisht duhet me funksionuar edhe laboratorët për analiza.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: A duhet me funksionuar pra edhe rëntgeni paralelisht, për atë janë kapacitetet për 27716 banorë? Shërbimet funksionojnë mirë dhe nuk kthehen pacientët prapa nëse nuk kanë terminë. Mirë është me funksionuar kapacitetet edhe në Doganaj, Kaçanik të Vjetër, por ne jemi Kaçanik, e dimë sa kemi buxhet, sa kemi punëtorë, nuk janë kapacitetet qysh po thoni ju se duhet me funksionuar. Lehtë është me thënë, se ne edhe kur kemi qenë me Hanin e Elezit, këto analiza janë bërë nga 8-13 ora. Sot i kemi 27716 banorëve, numri i banorëve është zvogëluar, ndërkaq kapacitetet shëndetësore janë rritur, janë rritur shërbimet, kështu që mos thoni se nuk janë duke u kryer shërbimet. Kur është fjala për raste emergjente, janë edhe autoambulanca në shërbim për to. A e din ti Kadrije që, prej spitalit në Prishtinë, dalin i bëjnë analizat privat.

znj. Kadrije Lika-Troni: Jo nuk e di.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, a jeni që KBAK për vitin 2026-2028 të shkoj në KK? Njëzëri u pajtuan të gjithë. Prezentë 6. Nuk ishte në sallë për momentin Agim Mani. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

**Korniza Afatmesme Buxhetore e Komunës (KABK) së Kaçanikut 2026-2028;
KBAK i**

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

3. Propozim Rregullore për transportin rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori i DSHPE Ramadush Osmani, është këtu, Rregullorja iu ka nënshtruar debatit publik, E hapi diskutimin:

znj. Ardita Rrahmani: Pse keni kërkuar me hequr pikën të neni 86.

z. Ramadush Osmani: Nëse Rregullorja ka shumë ndryshime, kalohet në rregullore të re. Ky detaj është teknik që ka mbetur nga rregullorja e kaluar e vitit 2014, kur kanë qenë rendet e udhëtimit dhe ndryshimet kanë qenë me të mëdha. Nëse mbetën, në momentin që hynë në fuqi kjo rregullore, unë detyrohem me i shpallur rendet e udhëtimit publik që i kemi miratuar deri në fund të vitit 2025.

znj. Ardita Rrahmani: Të linja e re, operatorët ekzistues që operojnë, a mos është kjo një pikë përjashtuese për kompanitë e reja, po e themi hipotetikisht se nuk kam ndonjë informatë që ka të reja të interesuara.

z. Ramadush Osmani: Jo nuk është. Kjo ndërlidhet kur në një linjë të caktuar, p.sh. të linjës Kaçanik-Dubravë, qytetarët kërkojnë një linjë fjala vjen prej orës 9. Unë i marrë nënshkrimet dhe si drejtori e vlerësoj nëse ka nevojë dhe shpallja hapet vetëm për atë linjë. Nëse kompania që e ka atë relacion, deklarohet se nuk ka mundësi për atë linjë. atëherë shkohet me kompanitë tjera.

znj. Ardita Rrahmani: Në kërkesat për "x" linjat specifike, a duhet me ardhur kërkesa prej një qytetari, apo duhet me u bërë ndonjë lloj peticioni apo diçka tjetër?

z. Ramadush Osmani: DSHPE përmes zyrtarëve ne i bëjmë analizat e nevojave, duke ia përshtatur relacionin punëtorëve, nxënësve dhe është një kohë mbrojtëse gjysmë ore. Nëse ka linjë në ora 9, atëherë 9 e 30 është linja tjetër. Kërkesat mund të vijnë edhe përmes administratorëve të asaj zone, kur vlerësohet se ka nevojë me pasur transport publik në atë kohë të caktuar. Bëhet analiza, hapet shpallja publike, dhe shikohet se a ka të interesuar. Kjo është çështje e biznesit privat, pasi nuk kemi ne operatorë që e subvencionon komuna. Kam pasur rastin për Kotlinë, është hapur shpallja, nuk ka pasur të interesuar, pastaj për Semajë është hapur shpallja.

z. Agim Mani: Të çështja e linjave, mendoj se është shumë e nevojshme me pasur një linjë në relacionin Ferizaj- Kaçanik, duke pasur parasysh se ka shumë prej komunës tonë që punojnë në Ferizaj, se ka qytetarë të komunës që për shkak të këtij transporti janë detyruar me lëshuar vendin, shkaku i një linje në këtë orë. Është shumë me rëndësi që kjo linjë me u bërë funksionale, mos me lënë në dorë të vullnetit të operatorëve, me futur në tender si pako. Ai që merr linjën ditore, me pasur edhe këtë pa llogaritur shumë fitimin, se kjo është urgjente dhe shumë e rëndësishme për qytetarët e komunës tonë. Mungesa e një linjë në këtë orë, ka ndikuar shumë për lëshimin e vendit me shkuar me banim në Ferizaj. Po flas vetëm për fshatin tim apo lagjen time, tri familje janë detyruar me banuar në Ferizaj, për shkak të transportit. Është mirë me shqyrtuar këtë çështje.

z. Ramadush Osmani: Ne jemi përgjegjës për linjën urbane periferike, si të kalon në linjë ndër urbane kalon në kompetenca të ministrisë linja, për miratim. Mundet me iu adresuar një kërkesë ministrisë, që në linjën e caktuar ata kur e kanë shpalljen, me paraparë. Linjat ndër urbane as nuk i parashohim as nuk i miratojmë ne si komunë.

Kryesuesi i Kuvendit: Nëse bëhet një linjë e tillë, ka me qenë me e ngarkuara, se shumë të rinj të komunës tonë qëndrojnë deri vonë në Ferizaj, pastaj ka punëtorë që punojnë deri në atë orë. Besoj se ka me pasur operatorë të interesuar për një linjë të tillë, por sa e di unë, ministria nuk lejon linjë pas orës 20:00 as prej Prishtine. Nuk e di qysh është e rregulluar me ndonjë rregullore të ministrisë, se sa e di unë, linjat i përfundojnë në ora 20:00.

z. Ramadush Osmani: Pas orës 20:00 përfundojnë linjat e transportit me autobus, dhe pas asaj kohe operojnë vetëm taksistët. Mundet me ekzistuar transport i veçantë i kompanisë, si p.sh. kompania "Elkos" mundet me pasur linjën e veçantë, ai quhet transport i veçantë. Edhe ne si komunë, transport publik pas orës 20:00 nuk kemi.

Kryesuesi i Kuvendit: Jo vetëm komuna jonë, por pas orës 20:00 nuk ka transport publik asnjë komunë. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim kjo pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri me ia kaluar KK. Prezentë 7. Në saje të kësaj del konstatimi se Kuvendi i Komunës mori këtë:

Aprovoj

**Propozim Rregullore për transportin rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut.
Propozim Rregullorja i**

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

4. Propozim Rregullore për transparencë e komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: Ne kemi pasur rregullore për transparencë, por sigurisht është ndryshuar ligji dhe duhet me ndryshuar rregulloren. E hapi diskutimin;

znj. Kadrije Lika-Troni: Përse rregullorja është në dy gjuhë?

znj. Fatlume Guri-Selimi: Është forma që na ka ardhur prej ministrisë, rregullorja është e njëjtë për të gjitha komunat e Kosovës. E ceku edhe kryesuesi se si komunë e kemi pasur edhe rregulloren edhe planin e veprimit për transparencë. Me herët rregullorja ka qenë e bazuar në 2 udhëzime administrative, tani është me udhëzimin administrativ për administratë në komuna. Ne jemi detyruar me hartuar rregulloren në bazë të këtij udhëzimi. Rregullorja është hartuar nga zyrtarët e komunave dhe është e njëjtë për krejt komunat.

Kryesuesi i Kuvendit: Ne krejt rregulloret e vendimet i përkthejmë pasi të aprovohen në KK. Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim rregulloren për transparencë, dhe e njëjta u aprovua njëzëri Për. Prezentë 7. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Rregullore për transparencë e komunës së Kaçanikut. Propozim Rregullorja i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

5. Plani i veprimit për transparencë e komunës së Kaçanikut;

Kryesuesi i Kuvendit: E hapi diskutimin: Për diskutim nuk u paraqit kush, atëherë e shtroj në votim për aprovim dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në saje të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj
Planin e veprimit për transparencë e komunës së Kaçanikut. Ky plan i veprimit i
Rekomandohet
Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

6. Propozim Vendimi për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2025;

Kryesuesi i Kuvendit: Drejtori është këtu, ZKF është këtu, E hapi diskutimin:

z. Agim Mani: Kur është miratuar buxheti, unë kam pasur kritika nga bashkëfshatarët e mijë për miratimin e shumë 50 mijë euro për rregullimin dhe rehabilitimin e rrugës "Adem Jashari". Unë ju kam thënë se kjo ka me qenë vetëm në letër se nuk ka me u realizuar ky projekt, dhe doli të jetë ashtu. Duke u bazuar në të kaluarën, edhe në të ardhmen mundën me u propozuar 100mijë euro, por mos me u realizuar e me i orientuar diku tjetër. Kur mjetet ndahen për një projekt, pse po i merr nga ai projekt? Ku jeni duke i orientuar këto mjete?

z. Ramadush Osmani: Rialokimi i këtyre mjeteve është brenda drejtorisë, mjetet prej një projekti të f. Stagovës, kanë shkuar përsëri në një projekt të f. Stagovë.

z. Agim Mani: Unë po e kontestoj projektin e rrugës: Stagovë-Runjevë, e cila është në fazën e punimeve, ndërkaq mjetet nuk i keni të zotuar.

z. Ramadush Osmani: Ai projekt është i mëhershëm, procedurat janë kryer.

z. Agim Mani: Projekti është më herët, por pa mjete të mjaftueshme. Nëse i keni pasur mjetet e mjaftueshme për projektin, nuk ka nevojë me shtuar përsëri mjete.

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Për projektin që po e thua Agim, kur janë udhëhequr procedurat, kanë qenë mjetet, por për vitin 2024, ankesat kanë vazhduar deri në janar apo shkurt 2025 dhe në momentin që e ka fituar projektin operatori, ti dashe apo jo, ligjërisht është dashur me ia proceduar mjetet, me ia kryer obligimin.

z. Rustem Zenuni: Agimi ose nuk është duke e kuptuar, ose është duke u munduar që ne me dalë jo mirë para qytetarëve.

z. Agim Mani: Kur mjetet janë të ndara për projektin, pse po ia merr projektit ato mjete?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Ka shumë projekte tjera që janë tërhequr mjetet, për shkak të kontratës kolektive, është aneksi i shkollës 100 mijë euro janë tërhequr, aneksi në Strazhë, aneksi i çerdhes dhe projekte tjera.

znj. Ardita Rrahmani: Të çështja e shkollës "Emin Duraku", e kam pa në e-prokurimi se ka dalë tenderi. Sa e di unë 70% e mjeteve duhet me qenë të zotuar kur të shpallet tenderi. Janë 2 shkolla të tenderuar me u ndërtua, shkolla "Emin Duraku" dhe një shkollë e Livoçit të Poshtëm. Çka ka me ndodhur me shkollën "Emin Duraku", se tenderi është deri në fund të muajit korrik?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Çështja është se projektin e qet për 3 vjet realizimin, pastaj nëse kontrata ka me u nënshkruar për 2 milion euro, sivjet ia procedon 100 mijë euro, vitin vijues 1 milion euro, vitin 2027, 1 milion euro.

znj. Ardita Rrahmani: Ne si qytetarë të Kaçanikut, po duam me ditur me këtë tenderin e shkollës "Emin Duraku, a ka me u bërë shkolla, a kemi me participuar ne si komunë?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Procedurat i udhëheqë niveli qendror. Ne për momentin nuk kemi ndonjë marrëveshje mirëkuptimi. Sa e di unë, niveli qendror për 3 shkolla i ka ndarë 600 mijë euro për momentin, i udhëheqin procedurat për këto tri shkolla, afati për 3 vite. Nëse bëhet kontrata për 3 shkolla, shuma e projekteve ka me qenë diku 5 milion euro, pastaj shumë tjetër e procedojnë në vitin 2026, 2027, se përndryshe kur të nënshkruhet kontrata, operatori t'i merr mjetet.

znj. Ardita Rrahmani: Komuna po thuhet se nuk ka memorandum bashkëpunimi me ministrinë. Ndërkaq, nëse fillojnë punimet e shkollës fjala vjen në shtator, kush e merr përgjegjësinë për ata nxënës derisa të zgjasin punimet? A supozohet me u bërë memorandum bashkëpunimi?

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Besoj se duhet me krijuar ndonjë marrëveshje mirëbesimi, se nuk janë në pyetje 100 nxënës, por 700-800 nxënës. Duhet krijuar një marrëveshje mirëbesimi, për shkak të specifikave të kësaj shkolle, për numrin e madh të nxënësve, por nuk kemi arritur ende në atë fazë. Duhet me krijuar ndonjë marrëveshje për afatin kohor, e jo me na ndodhë si për shkollën në Doganaj, e cila është nisur nga viti 2019, me pas marrëveshje me iu bërë zgjidhje nxënësve, se është problem me ngarkuar një shkollë për 8-9 vjet, nuk kemi bërë kurrfarë zgjidhje. Shpresoj të mos vijmë në atë fazë.

z. Rrustem Zenuni: A ka diçka për shkollën në Doganaj?

Kryesuesi i Kuvendit: Sivjet mundet me përfunduar një fazë e punimeve, se edhe kompania nuk mundet me kryer punë me tepër. Projektin e kanë, se ata e kanë tenderuar me paramasë, material e të gjitha, ministria i ka projektet të gatshme projektet- i ka maketa

Kryetari i Komunës-Besim Ilazi: Ata e kanë hapësirën për kokë nxënësi dhe e shumëzojnë për m2, 5m2, kështu ka qenë për shkollën në Kaçanik të Vjetër dhe në Begracë, këto janë kritere të përcaktuara.

Kryesuesi i Kuvendit: Në momentin që lidhet kontrata, ata janë të obliguar me i siguruar mjetet. Unë qysh e pash, planin dinamik e kanë për 18 muaj, ndërkaq shkolla në Doganaj e ka pasur planin për 36 muaj. Me rëndësi është me qenë serioz, nuk është me rëndësi sa është plani dinamik.

z. Kadri Krivenjeva: Vlera e projektit tre shkollat, është 6 milion euro.

Kryesuesi i Kuvendit: Diskutime të tjera nuk ka, e shtroj në votim për aprovim këtë pikë dhe e njëjta u aprovua njëzëri. Prezentë 7. Në sajë të kësaj del konstatimi se KPF,

Aprovoj

Propozim Vendimin për rialokimin e mjeteve buxhetore sipas buxhetit të vitit 2025.

Ky propozim vendi i

Rekomandohet

Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe aprovim.

Diçka tjetër për këtë takim nuk pati, mbledhja i përfundoj punimet në ora 11: 56. Deri në fund të mbledhjes qëndruan të gjithë anëtarët 07.

Mbledhja e 6 (gjashtë) e Rregullt e Kuvendit të Komunës do të mbahet me 30.06.2025 (e hënë) në ora 11:00.

Procesmbajtës
Makfiri Malsiu

Malsiu

Kryesues i Kuvendit
Kemal Murseli

